



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

|                                 |            |                  |                   |
|---------------------------------|------------|------------------|-------------------|
| Pranuar - Prillogur / Prillogur |            |                  |                   |
| 30.03.2018                      |            |                  |                   |
| Nr. i Organi<br>Org broj        | Numri/Broj | Shtetë<br>Prilog | Vlera<br>Vrednosa |
| 01-110/05-242                   |            |                  |                   |



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## RREGULLORE

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES  
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 01-110/05-58, E DT.02.02.2018

VITI, 27.03.2018

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1, dhe 12.2 shkronja c të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Republikës Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.28/2008, nenit 2, paragrafi 1 dhe 2 lidhur me neni 9 dhe 13 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008), në harmoni të plotë me dispozitat e nenit 36.2, shkronja c të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe me rekomandimet e Komisionit të Ministrisë së Financave, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.03.2018, nxjerr këtë:

## **RREGULLORE**

### **Për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, me nr. 01-110/05-58, e datës 02.02.2018**

#### **Neni 1**

Kjo rregullore, ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, me Nr. 01-110/05-58, të datës 02.02.2018, me rekomandimet e Komisionit të Ministrisë së Financave.

#### **Neni 2**

Te rregullorja bazë, neni 10.25 i rregullores bazë, **pika trigonometrike të koordinatat X.Y**, duhet të përmirësohet, të jete koordinatat Y,X, me përshkrim pesë euro (5 €). Te rregullorja bazë duhet të **fshihet përshkrimi, ku çmimi është dy euro (2 €)**. Te pika poligonale, koordinata Y.X.Z, ku në **rregullore bazë çmimi është dy euro (2 €)**, duhet të rritet në tri euro (3 €). Me përshkrim në **rregulloren bazë duhet të fshihen përshkrimi, ku çmimi është dy euro (2 €)**. Rregullores bazë duhet të ju shtohen edhe këto pikat lidhëse, koordinatat Y,X me përshkrim tri euro (3 €). Pika nëpër koordinata Y,X,Z me përshkrim pesë euro (5 €), pika linjë koordinata Y,X,Z dy euro (2 €), vendosja e pikave trigonometrike pesëdhjetë euro (50 €). Këto ndryshim plotësime bëhen me rekomandimin e Komisionit të Ministrisë së Financave konform Udhëzimit administrativ Nr.05/2012 për tarifat e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale të ofruara nga Zyra Kadastrale Komunale (ZKK).

#### **Neni 3**

Te rregullorja bazë, neni 13.3.15, duhet të fshihen emrat **KEDS, PTK, IPKO** dhe zëvendësohen me tekstin Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike SHA, Vala Kosova Telekom, Telecommunication LLC (aktivitetet e telekomunikimit kabllor, primar).

#### **Neni 4**

Neni **21 dhe 41 i rregullores bazë pezullohen përkohësisht për vitin 2018**, ndërsa zbatimi i neneve 37, 38, 39, 40 janë në harmoni me Ligjin për Kundërvajtje.

#### **Neni 5**

Pjesët tjera të rregullores bazë mbesin të pa ndryshuara.

#### **Neni 6**

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen.

Viti, më 27.03.2018

KUVENDI I KOMUNES SË VITISË

KRYESUESI

Naim Pira

